



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri

**FJALA E KRYETARIT TË PREZENCËS NË TRYEZËN PËR RRIJTJEN E
PJESËMARRJES SË GRAVE NË PARTITË POLITIKE**

18 qershor 2012

Të nderuar pjesëmarrës!

Në emër të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, jam i kënaqur t'ju jap mirëseardhjen në këtë tryezë të rumbullakët mbi rritjen e pjesëmarrjes së grave në politikë, e cila organizohet në bashkëpunim me OSBE/ODIHR-in.

Ky aktivitet organizohet në kuadër të projektit të OSBE/ODIHR-it, "Gratë në Partitë Politike", që zbatohet në Shqipëri, Gjeorgji, Kazakistan, Kirgistan dhe Moldavi.

Ai është gjithashtu një dëshmi e vendosmërisë së Prezencës së OSBE-së për promovimin e barazisë gjinore këtu në Shqipëri.

Mbi të gjitha, kjo çështje ka të bëjë me të drejtat thelbësore të njeriut.

Ajo është gjithashtu në mënyrë të pazgjidhshme e lidhur me sigurinë.

Një barazi më e madhe gjinore është thelbësore për arritjen e sigurisë, zhvillimit dhe zbatimit të plotë të standardeve demokratike këtu në Shqipëri dhe në të gjithë rajonin ku OSBE-ja është e pranishme.

Rritja e pjesëmarrjes së grave në politikë është një element logjik në zhvillimin e barazisë gjinore.

Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur bëhet fjalë për partitë politike, të cilat janë mjete mjaft të rëndësishme të sistemit tonë të përfaqësimit, nga të cilët për zgjidhen liderët.

Fatkeqësisht, është fakt që numri i grave që përfaqësohen në funksione të kryesive të partive në Shqipëri vazhdon të jetë shumë i ulët. Kjo duhet të zgjidhet drejtpërdrejtë.

Për arsye të rolit thelbësor për demokracinë, partitë politike kanë një shkallë të lartë përgjegjësie për të prezantuar të gjitha ndryshimet e nevojshme për të rritur pjesëmarrjen e grave në politikë.

Demokracia kërkon që partitë politike t'i hapin radhët e tyre për një pjesëmarrje më të gjerë të grave në politikë dhe në të gjitha nivelet e vendimmarrjes.

Nëse kjo nuk realizohet, jo vetëm partitë politike, por edhe shoqëria si e tërë vuan nga mungesa e ideve të reja dhe liderëve të rinj. Kështu, potenciali për prezantimin e ndryshimeve në të mirë të publikut nuk realizohet plotësisht.

Si fillim, këto ndryshime duhet të përfshijnë procese vërtet demokratike gjithashtu brenda partive.

Për sa i takon ligjit, Kodi Zgjedhor i vitit 2008 prezantoi një kuotë gjinore prej 30% me qëllimin për të shtuar përfaqësimin e grave në Kuvend dhe në autoritetet vendore.

Gjithsesi, disa dobësi në formulimin ligjor u bënë të dukshme pas rezultatit të zgjedhjeve parlamentare të vitit 2009, ku u zgjodhën vetëm 23 gra nga 140 vende në Kuvend.

Numri i grave të zgjedhura në të gjitha nivelet vazhdon të jetë shumë më i ulët se standardet e shumicës së vendeve evropiane.

Shumë gra të afta vazhdojnë të jenë të përjashtuara.

Shumë gra vazhdojnë ta gjejnë veten të përjashtuara nga shërbimi publik.

Për ta thënë më thjesht, situata aktuale është e padrejtë dhe nuk reflekton frymën demokratike të nevojshme.

Partitë politike duhet të bëjnë më shumë.

Duhet të bëjnë më shumë për sa i përket kuotës gjinore, si për sa i përket frymës dhe gërmës së ligjit.

Duhet të bëjnë më shumë për të vendosur gra të afta në listat zgjedhore.

Duhet të bëjnë më shumë për të mbështetur gratë për trajnimin dhe zhvillimin e aftësive të tyre.

Të nderuar pjesëmarrës!

Krijimi i mundësive të barabarta për gratë për të qenë pjesëmarrëse të plota dhe aktive në politikë është një faktor kryesor i një shoqërie moderne dhe demokratike.

Justifikimi i mungesës së përfaqësimit të grave si një pjesë e "kulturës shqiptare" nuk mund të pranohet më. Sigurisht, jo për një popull, një komb, që ka aspirata të larta evropiane.

Ne duam të shohim që një retorikë e tillë të mbështet nga veprime bindëse.

Partitë politike duhet të punojnë shumë më tepër për këtë.

Ju ftoj të përdorni sa më mirë tryezën së sotme të rrumbullakët dhe trajnimin e nesërm.

Ju faleminderit!